



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1359/2 prot.

Pukë, më 04.10. 2024

**Lënda:** Dërgohet për shqyrtim Relacioni dhe Projekt-Vendimi

**KËSHILLIT BASHKIAK PUKË**

Të nderuar, këshilltarë!

Bashkëlidhur, ju dërgojmë për shqyrtim Relacionin dhe Projekt-Vendimin.

*“Për Miratimin e Nivelit të Pagave të Funkionarëve të Zgjedhur ose të Emëruar, të Nëpunësve Civilë e të Punonjësve Administrativë të Bashkisë Pukë dhe Institucioneve të Varësisë”.*

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

**KRYETARI**

**Rrok DODAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PUKE**  
**DREJTORIA MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. 1856 prot.

Pukë, më 04/10 2024

**PROJEKT –VENDIM**

Nr. 01, Datë 04 / 10 / 2024

*“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË BASHKISË PUKË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË”*

Këshilli i Bashkisë Pukë në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pukë, në mbështetje të nenit 51, nenit 54 shkronja “ç”, të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 për “Nëpunësin civil” (i ndryshuar); ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar; VKM nr.503, datë 01.08.2024 ‘Për disa ndryshime në VKM nr. 328, datë 31.05.2023 ‘Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; si dhe Vendimin nr. 47, datë 29.12.2023 të këshillit të Bashkisë Pukë ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026”, i ndryshuar:

**VENDOSI**

1. Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Pukë dhe Institucioneve të Varësisë, sipas tabelave bashkëlidhur.
2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Pukë me nr. 26.09. 2023 “Për Miratimin e Nivelit të Pagave të Funksionarëve të Zgjedhur ose të Emëruar, të Nëpunësve Civilë e të Punonjësve Administrativë të Bashkisë Pukë dhe Institucioneve të Varësisë”, shfuqizohet.

3. Këshilltarët të paguhen në masën 10% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë.
4. Kryetarët e fshatrave për Qytetin Pukë të paguhen në masën 10% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë.
5. Kryetarët e fshatrave për Njësitë Administrative të paguhen në masën 10% të pagës mujore të Administratorit.
6. Efektet financiare të shtrihen nga data 01.09.2024.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Administrata.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

*(Bashkëlidhur: Tabelat, si dhe relacioni sqarues)*

**Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

Sokol Gjoni



**Juristi**

Endrit Kraja



**KRYETARI**

**RROK DODAJ**



## Tabela 1.

Niveli i pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, nëpunësve civilë dhe punonjësve administrative (VKM nr.503, datë 01.08.2024 ‘Për disa ndryshime në VKM nr. 328, datë 31.05.2023 ‘Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore’; si dhe ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”;

### a. Funksionarë të zgjedhur:

1. Kryetar i Bashkisë. Niveli i pagës 240.000 lekë/muaj.
2. Sekretar i Këshillit të Bashkisë: **Arsim i lartë**  
**Niveli i pagës:** kategoria II-2; **Paga për pozicion,** 141,000 lekë/muaj.

### b. Funksionarë të emëruar:

1. Nënkryetar i Bashkisë: Niveli i pagës: 185.000 lekë/muaj.
2. Këshilltar i kryetarit: **Arsim i lartë**  
**Niveli i pagës:** Kategoria III-2; **Paga për pozicion,** 100,000 lekë/muaj.

### c. Administrator (me më pak se 5000 mijë banorë);

1. Njësia Administrative Gjegjan: Niveli i pagës: 120.000 lekë/muaj.
2. Njësia Administrative Qelëz: Niveli i pagës: 120.000 lekë/muaj.
3. Njësia Administrative Luf-Qerret: Niveli i pagës: 120.000 lekë/muaj.
4. Njësia Administrative Rrape: Niveli i pagës: 120.000 lekë/muaj.

### d. Nëpunës civil;

1. Sekretar i Përgjithshëm: **Arsim i lartë**  
**Niveli i pagës:** Kategoria I-5; **Paga për pozicion,** 170.000 lekë/muaj.
2. Drejtor Drejtorie: **Arsim i lartë.**  
**Niveli i pagës:** Kategoria II-2; **Paga për pozicion,** 141,000 lekë/muaj.
3. Përgjegjës sektori/kryeinspektor: **Arsimi lartë**  
**Niveli i pagës;** Kategoria III-2; **Paga për pozicion,** 100,000 lekë/muaj.



4. Specialist/inspektor: .Arsim i lartë.  
Grupi i diplomës 1, **Niveli i pagës:** kategoria IV-3; **Paga për pozicion,** 65.000 lekë/muaj.  
Grupi i diplomës 2, **Niveli i pagës:** kategoria IV-3; **Paga për pozicion,** 60.000 lekë/muaj.  
Grupi i diplomës 3, **Niveli i pagës:** kategoria IV-3; **Paga për pozicion,** 55.000 lekë/muaj
5. Specialist në Njësi Administrative: **Arsim i lartë**  
**Niveli i pagës:** kategoria IV-4; **Paga për pozicion,** 50.000 lekë/muaj/

Shtesa për vjetërsi në punë e përcaktuar në masën: i) 0.6%, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1-10) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit; ii) 0.8%, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11-20) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit; iii) 1%, pas çdo vit pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21-30) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha etrajtimit me pagesë papunësie.

**DREJTOR I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**SOKOL GJONI**

**KRYETARI**

**RROK DODAJ**




## Tabela nr.2

Masa e shpërblimit për anëtarët e këshillit të Bashkisë Pukë dhe kryetarët e fshatrave (neni 51 i ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; si dhe neni 9/c e ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar”;

Emërtimi	Masa e shpërblimit	Shpërblimi për person
Anëtarët e Këshilit Bashkiak	10 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë	24.000 lekë
Kryetar fshati në qytet.	10 e pagës së Kryetarit të Bashkisë	24.000 lekë
Kryetar fshati në Njësi Administrative	10 e pagës së Administratorit	12.000 lekë

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SOKOL GJONI



KRYETARI I BASHKISË

RROK DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1856/prot.

Pukë, më 04.10. 2024

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË BASHKISË PUKË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË”.**

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Pukë për efekt të zbatimit të VKM nr.503, datë 01.08.2024 ‘Për disa ndryshime në VKM nr. 328, datë 31.05.2023 ‘Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore’”, paraqet këtë relacion:

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 për “Nëpunësin civil” (i ndryshuar); ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar; VKM nr.503, datë 01.08.2024 ‘Për disa ndryshime në VKM nr. 328, datë 31.05.2023 ‘Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore’”, Bashkia Pukë në kuadër të ndryshimeve të kategorive dhe kufijve të nivelit të pagave, sipas VKM-së të sipërcituar (nr.503, datë 01.08.2024), ka bashkëngjitur tabelat 1 dhe 2 me sqarimet si më poshtë:

1. Në tabelën 1 është pasqyruar niveli i pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, dhe nëpunësve civilë sipas përcaktimeve të VKM nr.503, datë 01.08.2024 ‘Për disa ndryshime në VKM nr. 328, datë 31.05.2023 ‘Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore’”;



1. Në tabelë është parashikuar rritja e pagave në nivelin maksimal për funksionarët e zgjedhur, (Kryetari i Bashkisë **paga për pozicion 240.000 lekë/muaj** dhe Sekretari i këshillit të Bashkisë, **paga për pozicion 141.000 lekë/ muaj**).
2. Në tabelë është parashikuar rritja e pagës në nivelin maksimal për funksionarët e emëruar, (nënkryetarët e Bashkisë), **paga për pozicion 185,000 lekë/muaj**.
3. Në tabelë është parashikuar rritja e pagës (jo në nivelin maksimal) për administratorët e njësisive administrative, **paga për pozicion 120.000 lekë/muaj**.
4. Në tabelë është parashikuar rritja e pagës pagës për nëpunësit civil, sipas përcaktimeve të mëposhtme:
  - a. Sekretar i Përgjithëm, niveli maksimal; **paga për pozicion 170.000 lekë/muaj**.
  - b. Drejtorët e drejtorive, niveli maksimal; **paga për pozicion 141.000 lekë/ muaj**.
  - c. Përgjegjësit e sektorëve,( jo niveli maksimal), **paga për pozicion 100.000 mijë lekë/muaj**;
  - d. Specialistët e administratës në Bashki, (jo në nivelin maksimal), kategorizohen sipas nivelit të diplomës.(shih tabelën nr. 1, gërma d, pika 4).
  - e. Specialistët në njësi administrative, (jo niveli maksimal), **paga për pozicion 50.000 lekë/muaj**.
5. Gjthashtu, është parashikuar masa e shpërblimit për anëtarët e këshillit të Bashkisë Pukë dhe kryetarëve të fshatrave (tabela nr. 2).

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij projekt vendimi, i cili propozohet në përputhje të plotë të VKM nr.503, datë 01.08.2024.

Duke ju falënderuar për mbështetjen, ftoj secilin nga Ju t'a votoni propozimin për miratimin e projekt vendimit!

**Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

**Sokol Gjoni**

